



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM - ERZEN TIRANË

Nr. 3556/16 prot

Datë, 23 / 07 /2018

VENDIM

Nr. 23 Datë 12 / 07 /2018

PËR
MIRATIMIN E LEJES PËR HAPJEN E NJË PUS-SHPIMI, MARIKAJ-VORË
SUBJEKTI "SALILLARI" SHPK, PËR QËLLIME TEKNOLOGJIKE

Në zbatim të Ligjit Nr.111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore" përkatësisht neni 50 pika 2 dhe neni 56 pika 2; Vendimit Nr. 416 datë 13.5.2015 "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", Vendimit nr.5 datë 16.02.2016 për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor", Vendimit nr.6 datë 16.02.2016 për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujor", Këshilli i Basenit Ujor Ishëm-Erzen,

V E N D O S I :

1.Miratimin e lejes për hapjen e një pus shpimi me aktivitet në fushën e ndërtimeve për qëllime teknologjike (për larje inertesh), për subjektin "Salillari"shpk me administrator Z.Lulzim Salillari nga shpuesi profesionist Fatos Kopaci, me adresë; Marikaj Vorë.

Sipas raportit hidrogeologjik shpimi do të kryhet në koordinatat dhe me të dhënat si më poshtë:

- Koordinatat e grykës së pusit të projektuar X=43 86 736 Y=45 85 583 Z=87 m
- Kapaciteti i parashikuar 2,5 l/s
- Thellësia e shpimit të parashikuar 80 m
- Diametri i shpimit të pusit $\varnothing= 250$ mm
- Qëllimi i përdorimit: Ujë teknologjik për larje inertesh

2.Ngarkohet ABU Ishëm Erzen për zbatimin e këtij vendimi

3. Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes dhe njoftimit të palës së interesuar .

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR ISHËM-ERZEN

SEKRETAR
Dorina ÇAPUNI



KRYETAR
Suzana JAHOLLARI

